


TË DREJTAT TRASHËGIMORE TË GRAVE



Gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta në trashëgimi.

Megjithatë, ndonjëherë, traditat, presioni familjar dhe shoqëror në Kosovë pengojnë realizimin në praktikë të të drejtave të grave në trashëgimi. Trashëgimia dhe të drejtat tjera pronësore janë thelbësore për sigurinë ekonomike dhe sigurinë e grave. Qasja në pronë u siguron grave mundësinë që të jetojnë të pavarura dhe të gëzojnë prosperitet individual, nëse e dëshirojnë këtë. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që gratë t'i kërkojnë të drejtat e tyre dhe të rrisin ndërgjegjësimin e grave të tjera në komunitetet e tyre.

PYETJET MË TË SHPESHTA:

Babai im ka ndërruar jetë dhe gjithë pasurinë ua ka lënë vëllezërve të mi. A kam të drejtë në trashëgimi? Çka nëse nuk më ka përmendur në testamentin e tij?

Edhe nëse babai nuk ju ka përmendur në testament, jeni trashëgimtar/e ligjore. Bashkëshorti ose fëmija mund të përjashtohen nga trashëgimia vetëm në raste të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.¹ Trashëgimtarë të detyrueshëm janë fëmijët, të birësuarit, pasardhësit e tyre, bashkëshortët dhe prindërit e personit të vdekur.

Babai im ka ndërruar jetë, por ai dhe nëna ime nuk kanë qenë të martuar. A kam të drejtë në trashëgimi?

Po. Nëse atësia dihet ose vërtetohet me vendim të gjykatës ose të organit kompetent, ju keni të njëjtat të drejta në trashëgimi si fëmijët e lindur në martesë. Pjesa e detyrueshme e djemve dhe vajzave duhet të respektohet edhe nëse ata nuk përmenden në testament.



1. Për shembull, nëse keni kryer vepër penale ndaj prindit tuaj ose e keni privuar nga mjetet themelore të jetesës, dhe raste të tjera. Vlefshmëria e arsyeve të përjashtimit duhet të verifikohet nga gjykata.

Burri im e ka adoptuar ligjërisht fëmijën tim, por ai kishte edhe fëmijë nga një martesë e mëparshme. A kanë fëmijët e tij më shumë të drejta në trashëgimi se fëmija im?

Jo. Të gjithë fëmijët, të adoptuar dhe natyralë, edhe pasardhësit e tyre, kanë të drejta të barabarta në trashëgimi nga prindërit e tyre adoptues. Gjithashtu, prindërit nuk mund t'i përjashtojnë nga trashëgimia fëmijët nga martesat e tyre të mëparshme.

Nëse një i afërm që ka ndërruar jetë nuk ka lënë testament, kush duhet të trashëgojë?

Nëse personi nuk lë testament derisa është ende gjallë, trashëgimia do të shpërndahet sipas ligjit për trashëgiminë:

Radha e parë e trashëgimisë: fëmijët dhe bashkëshorti/ja* i/e të ndjerit/ës në pjesë të barabarta. Nëse njëri nga fëmijët ka vdekur para trashëgimlënësit, vendin e tij/saj e zënë nipërit/mbesat e trashëgimlënësit.

Radha e dytë e trashëgimisë: kur nuk ka fëmijë, trashëgimia i kalon bashkëshortit/es* dhe prindërve të të ndjerit/ës, ose vetëm prindërve nëse nuk ka bashkëshort pasjetues. Bashkëshorti/ja e trashëgon gjysmën e pasurisë dhe prindërit gjysmën tjetër në pjesë të barabarta.

Radha e tretë e trashëgimisë: kur nuk ka prindër dhe vëllezër e motra të të ndjerit, trashëgimia i kalon vetëm bashkëshortit/es të të ndjerit, i cili trashëgon tërë pasurinë. Nëse trashëgimlënësi nuk ka pasardhës, bashkëshort ose prindër, pasurinë e tij do ta trashëgojnë vëllezërit dhe motrat. Nëse nuk ka vëllezër



e motra, atëherë do të trashëgojnë gjyshërit e tij. Nëse trashëgimlënësi nuk lë trashëgimtar, trashëgiminë e merr komuna.

***Partnerët e pamartuar** kanë të njëjtat të drejta trashëgimore si bashkëshortët në rastet e parapara me ligj; ju lutemi shihni pyetjen më poshtë për çiftet e pamartuara.

Kam trashëguar një shtëpi nga një i afërm. A ka burri im ndonjë të drejtë pronësore mbi të?

Jo. Pasuria e fituar me trashëgimi është pronë e veçantë dhe ju përket vetëm juve. Gjithashtu, prona e blerë ose e fituar përmes transaksioneve të tjera para martesës është **pronë e veçantë** e juaja.

Burri im ka vdekur. Çka ndodh me pasurinë tonë të përbashkët? A mund ta kërkojnë fëmijët e mi?

Ju keni të drejtë të kërkonit pjesën që ju takon të **pasurisë së përbashkët** të fituar nga puna e bashkëshortit dhe/ose e juaj gjatë martesës. Pjesa që i ka takuar burrit tuaj do t'i bartet fëmijëve tuaj. Ju keni të drejtë të banoni në këtë pronë sa të jeni gjallë ose derisa të martoheni sërish. Nëse prona shitet, fëmijët duhet t'i sigurojnë nënës strehim.

Çka nëse kam qenë shtatzënë kur më ka vdekur burri? A ka të drejtë fëmija im të trashëgojë pasurinë e tij, edhe nëse foshnja nuk ka lindur ende?

Në parim, po. Nëse foshnja është ngjizur para vdekjes së trashëgimlënësit dhe është lindur e gjallë brenda 300 ditëve pas vdekjes së trashëgimlënësit, ai ose ajo ka të drejtë të trashëgojë.



Burri im ka parashtruar kërkesë për shkurorëzim pak para se të vdiste. A kam të drejtë të trashëgoj pasurinë e tij?

Jo. Një person nuk ka më të drejtë të trashëgojë nga bashkëshorti pas shkurorëzimit ose anulimit të martesës. Nëse bashkëshorti juaj ka parashtruar kërkesë për shkurorëzim dhe pas vdekjes së tij shkurorëzimi zbatohet me aktvendim të formës së prerë, ju nuk keni më të drejtë të trashëgoni. Megjithatë, kjo nuk ndikon në të drejtën tuaj për pasurinë e përbashkët të fituar gjatë martesës, e cila ende ju takon.

Unë kam qenë në marrëdhënie me partnerin tim, kemi jetuar bashkë dhe kemi pasur fëmijë të përbashkët, por nuk jemi martuar. A kam të drejtë të trashëgoj pasurinë e tij?

Po, ju keni të drejtë të trashëgoni nëse:

- marrëdhënia ka zgjatur së paku pesë vjet, ose së paku tri vjet nëse kanë lindur fëmijë nga kjo marrëdhënie, dhe;
- në momentin e vdekjes së partnerit, asnjëri prej jush nuk ishte i martuar ligjërisht me një person të tretë.

A mund t'ua bartë pasurinë fëmijëve të mi sa jam gjallë?

Çdo person mund t'ua kalojë pasurinë dhe ta ndajë atë mes fëmijëve të tij/saj ndërmjet personave të gjallë. Ky është një opsion praktik që prindërit t'ua bartin pronën e tyre të paluajtshme fëmijëve derisa ata janë ende gjallë, në vend të trashëgimisë pas vdekjes së tyre.

A mund ta bart pronën time te personat e tretë, goftë sa jam gjallë apo në testament?

Po, ju mund ta bartni pasurinë te palët e treta, por duhet të respektoni të drejtat e trashëgimisë së trashëgimtarëve ligjorë. Ju duhet të deklaroni në momentin e dhurimit ose më vonë, ose në testament, se dhurata nuk duhet të llogaritet në masën trashëgimore. Për informata më të hollësishme, ju lutemi kërkonj për krahe nga ndonjë përfaqësues ligjor ose ndihmë juridike falas. Ju lutemi shihni të dhënat e tyre të kontaktit më poshtë.

Kush është kompetent të merret me procedurat e trashëgimisë?

Noterët dhe gjykatat mund të hartojnë një testament në bazë të kërkesës së trashëgimlënësit. Në këtë rast, ata janë të detyruar t'ia lexojnë trashëgimlënësit testamentin e shkruar dhe më pas ta njoftojnë atë për pasojat juridike të testamentit.

Noterët dhe gjykatat duhet të sigurojnë mbrojtjen institucionale të të drejtave trashëgimore të grave. Noterët/gjykatat janë përgjegjëse për mbajtjen e seancave informuese për të informuar trashëgimtarët e mundshëm për të drejtat dhe detyrimet e tyre. Nëse një trashëgimtar shpreh qëllimin për të hequr dorë nga e drejta e trashëgimisë, noteri ose zyrtari i gjykatës duhet të bëjë një bisedë të veçantë me trashëgimtarin, pa praninë e trashëgimtarëve të tjerë, si dhe të sigurohet që të kenë kuptuar plotësisht pasojat e vendimit të tyre. Gjithashtu, noteri ose zyrtarët e gjykatës duhet të regjistrojnë provat dhe deklarimin e heqjes dorë përmes procesverbalit dhe regjistrimit audio dhe video. Nëse noteri/gjyqtarja dyshon se ndonjë trashëgimtare grua është nën presion për të hequr dorë nga trashëgimia e saj, ata duhet të refuzojnë heqjen dorë dhe t'ia përcjellin çështjen Prokurorit.



Nëse gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, një zyrtar thotë se është zakon që gratë të heqin dorë nga trashëgimia, duke bërë kështu presion ndaj meje ose ndonjë anëtarit të familjes, çfarë duhet të bëj?

Ju nuk jeni të detyruar të hiqni dorë nga e drejta juaj për të trashëguar. Secili anëtar i familjes ka të drejtë në trashëgimi. Një person mund të heqë dorë nga e drejta e tij/saj pronësore vetëm me vullnet të lirë, si dhe nëse ai/ajo i kupton plotësisht pasojat e vendimit të tij/saj. Mbani në mend se nëse hiqni dorë nga të drejtat tuaja për trashëgimi, do të humbni të drejtën për të marrë çdo pasuri dhe pronë të anëtarit të familjes që ka ndërruar jetë. Fëmijët tuaj do të humbin gjithashtu të drejtën e tyre për të trashëguar këtë pronë, përveç nëse ju deklaroni shprehimisht se hiqni dorë vetëm në emrin tuaj.

Çka duhet të bëj nëse zyrtari publik prapë insiston?

Mos nënshkruaj asgjë dhe largohu nga zyra. Roli i zyrtarit publik është t'ju ofrojë informata të qarta dhe objektive për të drejtat tuaja dhe pasojat ligjore të vendimit tuaj. Nëse zyrtari publik insiston, kërkoni mbështetje nga rrethi juaj, komuniteti ose shoqatat e grave, ndihma juridike falas dhe raportoni rastin te autoritetet përkatëse (Ministria e Drejtësisë, Prokuroria ose Avokati i Popullit).

Çka duhet të bëj nëse të afërmit e mi kërkojnë nga unë që të heq dorë nga trashëgimia?

- Ngrini zërin dhe kërkoni pjesën tuaj të trashëgimisë; mos hiqni dorë nga të drejtat tuaja, veçanërisht nëse jeni nën presionin e të afërmeve.
- Në rast të shkeljes së të drejtave tuaja, drejtoni shqetësimet që i keni te rrjetet dhe shoqatat e grave



dhe institucionet përgjegjëse (p.sh. Policia e Kosovës, Avokati i Popullit).

- Këmbëngulni që regjistrimi i pasurisë së krijuar gjatë martesës të bëhet në emër të të dy bashkëshortëve në Kadastër.

Informata shtesë

Çka mund të bëjnë anëtarët e familjes për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat në trashëgimi?

- Rritini djemtë dhe vajzat si të barabartë.
 - Mësoni vajzat se ato kanë të drejta të barabarta për të trashëguar pasurinë që i përket prindërve të tyre.
 - Mësoni djemtë se motra(t) e tyre kanë të drejtë në trashëgimi në të gjithë pasurinë e prindërve të tyre.
- Flisni me të afërmit dhe fqinjët tuaj; informojini se gratë në Kosovë kanë të drejta të barabarta për të trashëguar pasurinë e prindërve të tyre.
- Informoni familjarët tuaj se ata duhet të regjistrojnë pronën e krijuar gjatë martesës në emër të të dy bashkëshortëve në Kadastër.

Çka mund të bëjnë organizatat e shoqërisë civile?

Rritni ndërgjegjësimin në komunitetet tuaja dhe mbështetni dhe fuqizoni gratë që të ndihen rehat për të kërkuar pjesën e tyre të trashëgimisë. OSHC-të gjithashtu mund t'i referojnë gratë te shërbimet përkatëse mbështetëse në nivel lokal kur është e nevojshme.

Kush mund të më mbështesë nëse kam nevojë për këshilla ligjore, por nuk kam mjete të mjaftueshme?

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas ofron ndihmë dhe shërbime juridike falas për ata që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare. Ajo ka shtatë zyra rajonale dhe disa zyra mobile në mbarë Kosovën. Kontaktoni zyrën tuaj lokale dhe paraqitni rastin tuaj.

Lista e kontakteve

Ministria e Drejtësisë

Telefononi pa pagesë në këtë numër: 080010010

Telefoni: +383/38/200-18-009

Email: zkp.md@rks-gov.net

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

Telefononi pa pagesë në këtë numër: 08001177

Telefoni: 038 200 18 936

E-mail: Info.ANJF@rks-gov.net

Institucioni i Avokatit të Popullit

Telefononi pa pagesë në këtë numër: 0800 15555

Telefoni:+383 (0) 44 827 844

Email: info.oik@oik-rks.org

Oda e Noterëve të Kosovës

Telefoni: +383 38 726 018 & +383 45 299 989

E-mail: info@noteria-ks.org

Prokuroria

Telefoni:+383 (0) 38 200 18 710

E-mail: info.psh@rks-psh.org

Rrjeti i Grave

Telefoni: 038/245-850

Email: info@womensnetwork.org

Ligjet për trashëgiminë

- Ligji për Trashëgiminë: Ligji nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë, i ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-088:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2407>.

- Ligji për Procedurën Jokontestimore: Ligji nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore (), me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 06/L-007, neni 165A: **<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2608>.**



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë